FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 144 | 29 gusht | 2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 669, datë 7.8.2013	Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH-2010), si metadate……	6203
Vendim i KM nr. 672, datë 7.8.2013	Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2013 – 2014……	6207
Vendim i KM nr. 673, datë 7.8.2013	Për autorizimin e shoqërisë "Plastika-Albania" sh.p.k., për importin e mbetjeve të polietilenit për qëllime riciklimi……	6214
Vendim i KM nr. 674, datë 7.8.2013	Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2013 – 2014……	6215
Vendim i KM nr. 675, datë 7.8.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 366, datë 13.5.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë së Ersekës, të qarkut të Korçës"……	6222
Vendim i KM nr. 676, datë 16.8.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Presidencën……	6223
Vendim i KM nr. 677, datë 16.8.2013	Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik me erë (parqe eolike) dhënë shoqërisë "EN.ERGY" sh.p.k……	6223
Vendim i KM nr. 678, datë 16.8.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi, vënia në punë, administrimi e mirëmbajtja e hidrocentraleve të Gojanit, Gjegjanit, Peshqeshit, Ura e Fanit, Fangut……	6230

Vendim i KM nr. 701, datë 21.8.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare……	6238
Vendim i KM nr.714, datë 28.8.2013	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr. 1/242, ndërtesë, me sipërfaqe 801.4 m^2, pasurisë nr. 1/66, truall, me sipërfaqe 1266.6 m^2 dhe ndërtesë 183 m^2, ndodhur në zonën kadastrale 8150, Tiranë.....	6238

VENDIM
Nr. 669, datë 7.8.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRCAKTIMIN, KRIJIMIN DHE REALIZIMIN E KORNIZËS REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH-2010), SI METADATE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 4 të nenit 13 të ligjit nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH-2010), si metadate, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PËRCAKTIMI, REALIZIMI DHE MIRËMBAJTJA E KORNIZËS REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH-2010)

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Me këtë vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohet definimi, realizimi dhe mirëmbajtja e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptimin e këtij vendimi:

1. "Parametrat gjeodezikë bazë" janë një grup konstantesh të pranuara ndërkombëtarisht që lidhen me përcaktimin e formës së tokës dhe dinamikën e saj të cilat përdoren në gjeodezi.
2. "GRS80 (Geodetic Reference System)" është sistemi referues gjeodezik i përcaktuar në vitin 1980 dhe i pranuar ndërkombëtarisht.
3. "ETRS89 (European Terrestrial Reference System)" është sistemi koordinativ tokësor i Europës i pranuar nga nënkomisioni i Shoqatës Ndërkombëtare të Gjeodetëve (IAG) për Europën "EUREF" dhe i fiksuar në pjesën e qëndrueshme të pllakës kontinentale europiane.

"89" është indeksi që tregon vitin e realizimit të parë të tij dhe përputhet me vitin "epokën" e realizimit të ITRS (International Terrestrial Reference System) ose Sistemit Referues Tokësor Ndërkombëtar "Epoka 2010", lidhet me kohën (1 janar 2010) në të cilën duhet të llogariten koordinatat e rrjetit shtetëror GPS.

4. “UELN (United European Leveling Network)” është emri i rrjetit të bashkuar europian të nivelimit.

5. “EVERS (European Vertical Reference System)” është emri i sistemit të referimit europian për lartësitë.

6. “IGSN 1971 (International Gravity Standardization Network 1971)” është rrjeti gravimetrik standardizues ndërkombëtar i vitit 1971, nëpërmjet të cilit përcaktohet rrjeti unik gravimetrik.

7. “GNSS (Global Navigation Satellite Systems)” janë sistemet satelitore globale të navigimit të ndërtuara për të përcaktuar vendndodhjen, kohën dhe shpejtësinë.

8. “EUREF (European Reference Frame)” është emri i sistemit koordinativ i cili është pranuar zyrtarisht si kornizë referuese gjeodezike për BE-në.

9. “Rrjeti shtetëror GPS” është rrjeti që përfshin rrjetin pasiv GPS dhe rrjetin aktiv të stacioneve GNSS në territorin e vendit.

10. “Projeksioni hartografik” është element i bazës matematike për të gjitha llojet e hartave, nëpërmjet të cilit mundësohet paraqitja në rrafsh e sipërfaqes së lakuar të elipsoidit tokësor.

11. “Sistemi i ndarjes dhe emërtesës së hartave” është një sistem që përdoret për ndarjen dhe emërtimin e fletëve të hartave të shkallëve të ndryshme, duke na mundësuar njëkohësisht edhe lidhjen reciproke midis tyre.

Neni 3

1. Korniza referuese gjeodezike shqiptare që do të përdoret në Republikën e Shqipërisë do të quhet:

“Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare 2010” ose shkurt (KRGJSH-2010), ku “2010” është indeksi që lidhet me “epokën” në të cilën janë përcaktuar koordinatat e pikave gjeodezike të monumentalizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. KRGJSH-2010 do të përcaktohet duke u mbështetur në kornizën referuese gjeodezike europiane.

3. KRGJSH-2010 do të përdoret në të gjitha aplikacionet që lidhen me përdorimin e koordinatave në territorin e vendit.

4. Lidhja midis KRGJSH-2010 dhe sistemeve të tjera të përdorura në vendin tonë do të bëhet duke përdorur parametrat e transformimit të llogaritura për çdo rast.

Neni 4

1. KRGJSH-2010, materializohet në terren nëpërmjet ndërtimit dhe mirëmbajtjes së pikave gjeodezike, të cilat duhet të jenë të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e vendit, duke formuar kështu bazën unike gjeodezike të Republikës së Shqipërisë.

2. Për pikat e bazës unike gjeodezike të Republikës së Shqipërisë përcaktohen:

a) koordinatat gjeodezike;

b) lartësitë mbi nivelin e detit;

c) nxitimi i forcës së rëndesës;

d) deklinacioni magnetik.

Neni 5

1. Baza unike gjeodezike e Republikës së Shqipërisë përfshin rrjetet e mëposhtme:

a) rrjetin shtetëror GPS;

b) rrjetin shtetëror të nivelimit;

c) rrjetin shtetëror gravimetrik;

d) rrjetin e stacioneve mareografike;

e) rrjetin e stacioneve magnetometrike.

KREU II
PËRCAKTIMI I KORNIZËS REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH-2010)

Neni 6

1. KRGJSH-2010 përfshin:

a) parametrat gjeodezikë bazë të përcaktuar në Sistemin Referues Gjeodezik 1980 (GRS-80) siç pasqyrohen në shtesën (I);

b) sistemin koordinativ gjeodezik ETRS 89;

c) sistemin e lartësive që realizohet nëpërmjet reperave të rrjetit shtetëror të nivelimit të përfshirë në Rrjetin Unik Europian të Nivelacionit (UELN) dhe të përcaktuara në Sistemin Referues Vertikal Europian (EVRS) me ndihmën e të dhënave për forcën e rëndesës të unifikuara në sistemin International Gravity Standardization Network 1971 (IGSN 1971).

d) sistemin e koordinatave në plan, i cili mundësohet nga dy projeksione hartografike:

Projeksioni Tërthor Zonal i Merkatorit (TMzn) për harta në shkallë më të madhe se 1:500 000 dhe Projeksioni Konik Konform i Lambertit (LCC) për harta në shkallë 1:500 000 dhe më të vogla, duke përdorur si meridian qendror të zonës, meridianin $\lambda = 20^{o}$ gjatësi gjeografike lindore që përdoret në të gjitha punimet civile.

e) sistemin ndërkombëtar për ndarjen dhe emërtesën (nomeklatura) që përdoret për ndarjen dhe emërtesën e fletëve të hartave deri në shkallën 1:2500, siç pasqyrohet në shtesën (II).

KREU III
REALIZIMI DHE MIRËMBAJTJA E KORNIZËS REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH-2010)

Neni 7

KRGJSH-2010 realizohet dhe mirëmbahet nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ASIG, nëpërmjet realizimit dhe mirëmbajtjes së rrjeteve gjeodezike të parashikuara në nenin 5.

Neni 8

Rrjeti shtetëror GPS materializohet nëpërmjet ndërtimit të rrjetit shtetëror aktiv të stacioneve GNSS dhe rrjetit shtetëror pasiv GPS. Koordinatat e pikave të këtyre rrjeteve përcaktohen në sistemin ETRS 89, epoka 2010.

Neni 9

Rradha e kryerjes së punimeve, përgatitja e instruksioneve me kërkesat teknike për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të parashikuara në nenin 5, përfshi këtu rrjetin shtetëror pasiv GPS dhe rrjetin aktiv të stacioneve GNSS, përcaktohen dhe miratohen nga ministri përgjegjës për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor me propozimin e AISG-ut.

Neni 10

Transformimi i të dhënave dhe materialeve gjeodezike dhe hartografike ekzistuese në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare 2010 bëhet duke u mbështetur në instruksionet e miratuara nga ministri përgjegjës për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor me propozimin e ASIG-ut.

Neni 11

Sistemi i koordinatave kënddrejta (x, y) që përftohen duke u mbështetur në pikën “d” të nenit 6 të këtij vendimi, do të quhet “Sistemi koordinativ 2010”.

Neni 12

Deri në momentin e realizimit të plotë të rrjeteve të veçanta të parashikuara në nenin 5, rrjete nëpërmjet të cilave realizohet KRGJSH-2010, punimet për të cilat nuk është siguruar mbështetje nga KRGJSH-2010 do të mbështeten në rrjetet ekzistuese.

Shtesa I

1. Parametrat gjeodezikë bazë në sistemin GRS-80 janë:

a) Rrezja e ekuatorit të tokës: a = 6 378 137m;
b) Konstantja gravitacionale gjeocentrike e tokës duke përfshirë edhe atmosferën:
GM = 3 986 005 x 10^{-8} m^3s^{-2};
c) Faktori dinamik i figurës së tokës pa përfshirë baticën e qëndrueshme:
J_2 = 108 263 x 10^{-8};
Këtij faktori i korrespondon shtypja në pole: 1/f = 298.257 223 563;
d) Shpejtësia këndore e rrotullimit të tokës: ω = 7 292115.0 x 10^{-11}rad.sek^{-1}.

Shtesa II

1. Tabela për ndarjen dhe emërtesat e fletëve të hartave standarde për shkallët nga 1: 1 000 000 – 1:2500, në përputhje me nomenklaturën ndërkombëtare

	Shkalla	**Përmasat**		**Përcaktimi**	**Emërtesa**
		Gjerësia (φ)	**Gjatësia (λ)**		
1	1:1 000 000	4^0	6^0	Sipas hartës ndërkombëtare Shk 1:1 000 000	K-34
2	1: 500 000	2^0	3^0	1/4 e fletës së hartës Shk 1:1 000 000	K-34-A, B, C, D
3	1: 200 000	40’	60’	1/36 e fletës së hartës Shk 1:1 000 000	K-34-I, II, III, …XXXVI
4	1: 100 000	20’	30’	1/144 e fletës së hartës Shk 1:1 000 000	K-34-1, 2, 3, …144
5	1: 50 000	10’	15’	1/4 e fletës së hartës Shk 1: 100 000	K-34-…40… A, B, C, D
6	1: 25 000	5’	7’ 30”	1/4 e fletës së hartës Shk 1: 50 000	K-34-40-B-a, b, c, d
7	1:10 000	2’ 30”	3’ 45”	1/4 e fletës së hartës Shk 1: 25 000	K-34-40- A-a -1, 2, 3, 4
8	1:5 000	1’ 15”	1’ 52.5”	1/256 e fletës së hartës Shk 1: 100 000	K-34-40-1, 2, …256
9	1:2 500	37.5”	56.25”	1/4 e fletës së hartës Shk 1: 5 000	K-34-40-(256)-a, b, c, d

Për ndarjen dhe emërtesën e fletëve të hartave për shkallë më të mëdha se shkalla 1:2500 do të përdoret ndarja dhe emërtesa e parashikuar në “Udhëzuesin metodik për plotësimin e kartelës së pasurive të paluajtshme”, e miratuar nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me nr. protokolli 76, datë 13.9.1999.

VENDIM
Nr. 672, datë 7.8.2013

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2013 - 2014

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 6, 19 e 28 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të nenit 57 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 1 e 5 të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të nenit 29 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit, që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike dhe studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Përfitojnë bursë nxënësit dhe studentët, brenda kuotave dhe kritereve të përcaktuara në këtë vendim:

2.1 Sipas kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) Nxënësit/studentët, që vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre në largësinë mbi 5 km dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Nxënësit, që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km e që vendosen në konvikt publik.

c) Nxënësit/studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

ç) Nxënësit/studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

d) Secili nga studentët, bashkëshort me fëmijë, që plotëson kriterin ekonomik dhe që vendoset në konvikt publik.

dh) Fëmijët, nxënës apo studentë, që kanë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë):

a) Nxënësit e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

b) Nxënësit, të cilët vazhdojnë studimet në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore dhe ndërtim, në vitet e dyta e lart, dhe që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

c) Studentët, që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që kanë mbaruar shkollën e mesme me medalje ari.

ç) Studentët, që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që janë shpallur nga

Ministria e Arsimit dhe Shkencës më të mirët e maturës shtetërore, sipas renditjes në listën e vlerësimit të realizuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve. Për vitin akademik 2013-2014, numri i tyre do të jetë 25 (njëzet e pesë) studentë. Kjo kategori studentësh përfiton bursë kur ata vazhdojnë studimet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe vetëm për vitin akademik 2013-2014.

d) Studentët që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

dh) Studentët që vazhdojnë studimet në programin e studimit "Matematikë" dhe në programin e studimit "Fizikë", në vitin e dytë e lart, dhe kanë mbaruar vitin akademik paraardhës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

Nxënës apo studentë, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

Në fillim të çdo viti akademik, por jo më vonë se data 15.12.2013, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit të dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listën për këtë kategori nxënësish/studentësh.

2.4 Sipas degëve prioritare për zhvillimin e ekonomisë (nxënës):

Nxënësit, që regjistrohen në shkollat e mesme profesionale në degët bujqësore, veterinare, pyjore, ndërtim, shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit dhe gjeologji-miniera. Prioritet në trajtimin me bursë kanë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale dhe me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit, si: Tropoja, Hasi, Puka, Kukësi, Dibra, Bulqiza, Mati, Mirdita, Malësia e Madhe, Librazhdi, Gramshi, Kolonja, Përmeti, Pogradeci, Skrapari dhe rrethi Tepelenë.

3. Nxënësit dhe studentët e të gjitha kategorive të sipërpërmendura nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të bursës, kur:

a) janë ndarë nga trungu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;

ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, për drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA), për vitet e para, sipas kuotave të miratuara (për nxënës/studentë). DAR/ZA-të, pas këshillimit me njësitë bazë të qeverisjes vendore, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave dhe e dërgojnë në njësitë bazë të qeverisjes vendore (bashki/komunë), në përshtatje me kërkesat e paraqitura paraprakisht prej tyre për kategoritë, sipas pikës 2.1 të këtij vendimi.

5. Njësitë bazë të qeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar për to nga DAR/ZA-të, vendosin, me këshillat e tyre, për dhënien e bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2 dhe 2.4 të këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve dhe studentëve nga shtresat sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë ose, në pamundësi, trajtimin me gjysmë burse.

5.1 Njësitë bazë të qeverisjes vendore, detyrimisht, duhet t'u dërgojnë, në rrugë zyrtare, institucioneve publike të arsimit të lartë, njësive bazë të qeverisjes vendore, drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore përkatëse, vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

5.2 Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore duhet të dërgojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, si dhe bashkive/komunave që menaxhojnë konviktet, listën emërore të nxënësve dhe të studentëve, përfitues të bursës, së bashku me vendimet origjinale të këshillave të bashkive dhe të këshillave të komunave. Një kopje e listës emërore të nxënësve dhe studentëve të trajtuar me bursë dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

5.3 Informacion për nxënësit që regjistrohen dhe vazhdojnë studimet në vitin e parë shkollor

2013-2014, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore, ndërtim, shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe të gazit dhe gjeologji-miniera, u dërgohet njësive bazë të qeverisjes vendore nga drejtoria arsimore rajonale dhe zyra arsimore, të cilat, jo më vonë se data 15.10.2013, vendosin për dhënien e bursave sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve në të cilat janë vendosur nxënësit mbështetur në numrin e nxënësve të regjistruar në këto degë, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin akademik 2013-2014. Drejtoria arsimore rajonale dhe zyra arsimore menjëherë, me mbarimin e regjistrimit në këto degë, dërgojnë informacion në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Bursat e nxënësve, për vitin e dytë e lart, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga këshilli i bashkisë dhe i komunës, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Drejtoritë arsimore rajonale paraqesin/dërgojnë zyrtarisht në njësitë vendore kërkesat për miratim burse për nxënësit që përfitojnë bursë sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të pikës 2.2 të këtij vendimi.

Nxënësit që vitin e parë kanë përfituar bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës ku ata kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

Nxënësit e klasës së12-të të shkollës së mesme “Nazmi Rushiti”, Dibër, dhe nxënësit e klasës së12-të të shkollës së mesme “Havzi Nela”, Kukës, të cilët transferojnë programet e nivelit të dytë në shkollat e mesme profesionale, Shkodër, pra nga njësitë vendore, bashkia Peshkopi dhe bashkia Kukës, në njësinë vendore, bashkia Shkodër, njëkohësisht transferojnë zyrtarisht në bashkinë Shkodër, numrin e bursave (listën e nxënësve), që kanë përfituar bursë për vitin shkollor 2012-2013.

Për nxënësit e tjerë të klasës së 12-të të shkollës së mesme “Nazmi Rushiti”, Dibër, dhe nxënësit e klasës së12-të të shkollës së mesme “Havzi Nela”, Kukës, që plotësojnë kriteret ekonomike dhe kriterin e largësisë nga vendbanimi sipas pikës 2.1 “Sipas kriterit ekonomik”, kërkesat e tyre shqyrtohen dhe trajtohen me bursë nga njësia e qeverisjes vendore, bashkia Shkodër.

6.1 Nxënësit, që kanë përfituar bursë, e përfitojnë atë dhe gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale. Bursa jepet në formën e kuotës ushqimore nga njësia bazë e qeverisjes vendore gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore.

Nxënësve të klasës së 13-të të shkollave profesionale, drejtimi instalues i sistemeve termohidraulike, që nuk kanë përfituar bursë me vendim të këshillave të njësive të qeverisjes vendore, për periudhën e zhvillimit të praktikës profesionale, miratuar për vitin akademik 2013-2014, u akordohet/miratohet bursë nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në kërkesën e drejtorisë arsimore rajonale.

Bursat e akorduara/miratuara nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës u dërgohen zyrtarisht njësive bazë të qeverisjes vendore sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit që zhvillojnë praktikën profesionale. Nxënësit e përfitojnë bursën në formën e kuotës ushqimore. Drejtorët e shkollave profesionale e social-kulturore dërgojnë zyrtarisht çdo muaj, pranë njësive bazë të qeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale për nxënësit që përfitojnë bursë.

7. Bursat e studentëve, për vitin e dytë e lart, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët e vitit të dytë e lart, që nuk kanë përfituar bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të planit të bursave, të përcaktuara sipas këtij vendimi.

Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët që përfitojnë bursë sipas pikës 2.2 është deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin akademik 2013-2014. Institucionet publike të arsimit të lartë paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kërkesat për studentët që përfitojnë bursë sipas shkronjave “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 2.2 të këtij vendimi.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes dhe e dërgon për ekzekutim në institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët që vitin e parë kanë përfituar bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

8. Nga plani i bursave të miratuara për vitin akademik 2013-2014, Bashkisë së Tiranës i jepen deri 10 (dhjetë) bursa për studentët, të cilët, pavarësisht nga kriteri i vendbanimit apo kritereve ekonomike, kanë statusin ligjor të jetimit, si dhe statusin e invalidit paraplegjik apo tetraplegjik, ndërsa bashkive të tjera, të cilat në vendndodhjen e tyre territoriale kanë institucione të arsimit të lartë publik për këtë kategori studentësh, u jepen deri në 3 (tri) bursa.

9. Nxënësit dhe studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përfitojnë falas veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr. 6 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme që ofrojnë shkollat.

9.1 Nxënësve dhe studentëve, që kanë përfituar statusin e jetimit, u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës dhe të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

9.2 Nxënësit jetimë, që vazhdojnë shkollat e mesme ose institucionet publike të arsimit të lartë, trajtohen me pagesë suplementare dhe për periudhën e pushimeve verore që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, si dhe vetëm një vit kur humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese, nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale.

9.3 Fëmijët/nxënësit dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, me nevoja të veçanta psikosociale, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një kuotë ushqimore (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë.

10. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë. Bursa përllogaritet si shpenzim mesatar, lekë në ditë, dhe paguhet çdo muaj me kalim në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti. Drejtuesit e fakulteteve dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësive/departamentit të financës, frekuentimin e shkollës për studentët që përfitojnë bursë.

10.1 Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga bashkia e komuna, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Masa mujore e bursës u jepet nxënësve në formën e kuotës ushqimore, në konvikt.

10.2 Nxënësve, të cilët për mungesë kapacitetesh, nuk janë vendosur/akomoduar në konvikte apo që përfitojnë bursë jashtë kriterit ekonomik, masa e miratuar e bursës mujore u paguhet çdo muaj nga bashkia/komuna, në llogarinë bankare të nxënësit/prindit përfitues, pranë bankave të nivelit të dytë apo në zyrat e Postës Shqiptare. Drejtorët e shkollave profesionale e social-kulturore dërgojnë zyrtarisht çdo muaj, pranë njësive bazë të qeverisjes vendore, informacion për ndjekjen/frekuentimin e shkollës për nxënësit që përfitojnë bursë.

11. Niveli/masa e bursës për nxënësit dhe studentët jepet sipas pasqyrave nr. 2 e nr. 3 dhe kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrave nr. 4 e nr. 5, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për vitin e ri akademik 2013-2014, të japë 1650 (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) bursa për nxënësit dhe 1900 (një mijë e nëntëqind) bursa për studentët, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

13. Efektet financiare të vitit akademik 2013-2014 të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për vitin 2013, për pjesën e vitit 2013, si dhe

nga fondet e Buxhetit të Shtetit që do të miratohet për vitin 2014, për pjesën e vitit 2014.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para, është data 15 dhjetor 2013, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitin e dytë e lart është data 15 nëntor 2013. Vendimet e miratuara nga këshillat bashkiakë apo këshillat e komunës jashtë këtij afati janë të pavlefshme.

15. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, për raste të veçanta, kur vendimet e këshillave të njësive bazë të qeverisjes vendore janë miratuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 14 të këtij vendimi, por dërgohen jashtë afatit të përcaktuar, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të rivendosë në afat përfitimin e bursës për nxënësin/studentin.

16. Vendimet e njësive bazë të qeverisjes vendore dhe ato të institucioneve publike të arsimit të lartë bëhen publike për komunitetin, median dhe institucionet e tjera vendore apo qendrore.

17. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë bazë të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Pasqyra nr.1: **KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT DHE STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS (VITI MËSIMOR 2013- 2014)**

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmë bursa	Me pagesë
	Për qytetin	Me të ardhura	Me të ardhura	Me të ardhura
		mujore lekë/frymë	mujore lekë/frymë	mujore lekë/frymë
1	Për familjet me 2 persona	Deri 3,200	3,200-4,600	Mbi 4,600
2	Për familjet me 3 persona	Deri 3,100	3,100-4,500	Mbi 4,500
3	Për familjet me 4 persona	Deri 3,000	3,000-4,400	Mbi 4,400
4	Për familjet me 5 persona	Deri 2,900	2,900-4,300	Mbi 4,300
5	Për familjet me 6 persona	Deri 2,800	2,800-4,200	Mbi 4,200
6	Për familjet me 7 persona	Deri 2,700	2,700-4,100	Mbi 4,100
7	Për familjet me 8 persona	Deri 2,600	2,600-4,000	Mbi 4,000

Shënim. Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike, në varësi të masës së kësaj ndihme, brenda planit të akorduar për secilën njësi bazë të qeverisjes vendore.

Pasqyra nr.2 NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT (VITI MËSIMOR 2013- 2014) Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi	Financimi
		Për kuotë	Shpenzime	Totali i	nga nxënësi	nga shteti
		ushqimi	vetjake	kuotës		
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	a) Bursa	6,165	200	6,365	0	6,365
	b)Gjysmë bursa	6,165	200	6,365	3,182	3,183
	c)Me pagesë	6,165	200	6,365	6,365	0
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive dhe Arsimi Special					
	a)Bursa	6,683	200	6,883	0	6,883
	b)Gjysmë bursa	6,683	200	6,883	3,441	3,442
	c)Me pagesë	6,683	200	6,883	6,663	0
3	Nxënësit jetimë	6,683	200	6,883	0	6,883

Pasqyra nr.3; NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT (VITI MËSIMOR 2013- 2014) Në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi	Financimi
		Për kuotë	Shpenzime	Totali i	nga studenti	nga shteti
		ushqimi	vetjake	kuotës		
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe shkollat e tjera të larta					
	a) Bursa	6,900	2,000	8,900	0	8,900
	b) Gjysmë bursa	6,900	2,000	8,900	4,450	4,450
	c) Me pagesë	6,900	2,000	8,900	8,900	0
2	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve					
	a)Bursa	7,410	2,000	9,410	0	9,410
	b)Gjysmë bursa	7,410	2,000	9,410	4,705	4,705
	c)Me pagesë	7,410	2,000	9,410	9,410	0

Pasqyra nr.4 :
KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE VITI MËSIMOR 2013-2014.

Nr.	EMERTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lekë	Vlera ditore ne lekë
1	Bukë	gram	350-400	977	100	35
2	Makarona	gram	30	107	120	3.6
3	Oriz	gram	30	109	150	4.5
4	Sheqer	gram	40	157	100	4
5	Fasule	gram	30	93	150	4.5
6	Perime	gram	130	27	100	13
7	Fruta	gram	100	42	100	10
8	Vaj	gram	30	270	180	5.4
9	Gjalpë	gram	20	152	531	10.62
10	Mish	gram	70-80	115	750	52.5
11	Djathë	gram	25	40	400	10
12	Reçel	gram	20	93	250	5
13	Vezë	kokërr	1	42	12	12
14	Qumësht	gram	200	98	80	16
15	Patate	gram	200	170	40	8
16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			**2712**		**206**

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas mënyve të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e në proceisin e prokurimeve publike dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

Pasqyra nr.5 :KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E STUDENTËVE(VITI MËSIMOR 2013 -2014)

Nr.	EMERTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lekë	Vlera ditore në lekë
1	Bukë	gram	350-400	1,117	100	35
2	Makarona	gram	30	107	120	3.6
3	Oriz	gram	40	145	150	6
4	Sheqer	gram	40	157	100	4
5	Fasule	gram	40	124	150	6
6	Perime	gram	120-130	27	100	12
7	Fruta	gram	100	42	100	10
8	Vaj	gram	40	360	180	7.2
9	Gjalpë	gram	20	152	531	10.62
10	Mish	gram	80-100	140	750	60
11	Djathë	gram	42	66	400	16.8
12	Reçel	gram	44	190	250	11
13	Patate	gram	200	170	40	8
14	Qumësht	gram	200	98	80	16
15	Vezë	kokërr	1	42	12	12
16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			**3,037**		**230**

Pasqyra nr.6 KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES (VITI MËSIMOR 2013-2014)

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7,000 (shtatë mijë) lekë
2	Për jetimët	10 ,000 (dhjetë mijë) lekë

VENDIM
Nr. 673, datë 7.8.2013

PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË "PLASTIKA-ALBANIA" SHPK, PËR IMPORTIN E MBETJEVE TË POLIETILENIT PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë "Plastika-Albania" sh.p.k., për importin e mbetjeve të polietilenit me kodet e mëposhtme tarifore:

- GH 011 ex 39 15 10 00;
- B3010,

të Konventës së Bazelit, sipas aneksit 1 "Mbetjet e listës së gjelbër", bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi", të ndryshuar.

2. Sasia e mbetjeve të polietilenit që importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 600 (gjashtëqind) tonë në vit.

3. Mbetjet importohen nga shteti i Greqisë. Transporti të bëhet në rrugë tokësore dhe detare, pasi të jetë plotësuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim dhe riciklim", dhe anekseve III dhe IV bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

4. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve shoqëria "Plastika-Albania" sh.p.k., dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në anekset III dhe IV bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe monitorimi i tyre të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

5. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve të polietilenit nga shoqëria "Plastika-Albania" sh.p.k. është njëvjeçare dhe fillon me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve të polietilenit nga shoqëria "Plastika-Albania" sh.p.k. pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe me ato ku do të kryhet kalimi transit i mbetjeve, për autorizimet përkatëse, në bazë të të cilave lejohet kalimi i kësaj sasie të mbetjeve të polietilenit, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit "Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre", konventë në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 674, datë 7.8.2013

PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2013 - 2014

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidëve të punës", të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik ", të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit" dhe të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, për vitin akademik 2013 - 2014, të jenë 9 402, të cilat ndahen, si më poshtë vijon:

a) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme	8522;
b) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë	40;
c) Kuotat për transferim studimesh	200;
ç) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit	400;
d) Kuota për personat që nuk shikojnë	20;
dh) Kuota për romët/ballkano-egjiptianë	20;
e) Kuota për të përndjekurit politikë	150;
ë) Kuota për shtetasit e huaj	50.

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, sipas shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kuotat e çdo programi studimi ndahen në raportin 7:3, përkatësisht 70% të tyre, për pranimet e reja, për programe të para studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe 30%, për pranimet e reja për programe të dyta studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme.

3. Kuotat për transferim studimesh, të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuotat e përcaktuara në shkronjën "ç" të pikës 1 të këtij vendimi, për kandidatët shqiptarë nga Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, pasqyrohen në tabelën nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi dhe prefektura e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit

të lartë në Republikën e Shqipërisë. Rishpërndarja e kuotave të paplotësuara kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke marrë parasysh edhe kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

5. Kuotat e pranimeve për personat që nuk shikojnë ndahen për kandidatët me statusin për personat që nuk shikojnë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

6. Kuotat e pranimeve për romët dhe ballkano-egjiptianët ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e Romëve dhe Shoqata Kombëtare e Ballkano-Egjiptianëve dhe të vërtetuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Kuotat e pranimeve për të përndjekurit politikë ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Instituti i Integrimit të të Përndjekurve Politikë dhe plotësimit të kritereve të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë.

8. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj, të përcaktuara në shkronjën "f" të pikës 1 të këtij vendimi, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe, si dhe në bazë të kërkesave individuale, të paraqitura në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nga persona të interesuar.

9. Çdo shtetas shqiptar, i cili ka përfunduar shkollën e mesme dhe zotëron diplomë të maturës shtetërore, dëftesë pjekurie apo çdo diplomë tjetër studimi, të fituar brenda ose jashtë vendit, të barasvlershme me të, ka të drejtë të aplikojë për në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme dhe edukimit në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

